

**URDHËR**  
**Nr. 13, datë 1.4.2016**

**PËR DELEGIM KOMPETENCASH**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës, neneve 27–33, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, bazuar në faktin se sipas Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin “Ofrimi i shërbimeve publike me në qendër qytetarin”, të ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me ligjin nr. 3/2016, ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike i ngarkohen një sërë detyrash dhe përgjegjësish, bazuar në faktin se ministri i Shtetit nuk disponon një aparat ministror që të mbështesë veprimtarinë e tij, si dhe bazuar në parashikimet e marrëveshjes së lartpërmendur, e cila kërkon ngritjen dhe mbajtjen në funksionim të Njesisë së Menaxhimit të Projektit gjatë gjithë zbatimit të projektit për të kryer përgjegjësitë e menaxhimit të përgjithshëm të tij,

**URDHËROJ:**

Delegimin e kompetencave që ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike gëzon në bazë të Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin “Ofrimi i shërbimeve publike me në qendër qytetarin”, të ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me ligjin nr. 3/2016, tek Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), si më poshtë:

1. ADISA-ja realizon komunikimin zyrtar me institucionet dhe njësitë e tjera të përfshira në projekt, për të përmbushur realizimin e aspekteve teknike të veprimtarive të nevojshme për zbatimin e marrëveshjes.

2. ADISA-ja lidh të gjitha kontratat që janë të nevojshme për zbatimin e detyrimeve të marra përsipër në kuadër të Marrëveshjes dhe për realizimin e projektit, të përmendura në planin e miratuar të prokurimit me Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim dhe në përfundim të procedurave të përzgjedhjes të realizuara në përputhje me procedurat e kësaj Banke.

3. ADISA-ja realizon të gjitha funksionet e tjera me natyrë teknike të nevojshme për zbatimin e detyrimeve që burojnë nga Marrëveshja dhe për realizimin e projektit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I SHTETIT PËR INOVACIONIN**  
**DHE ADMINISTRATËN PUBLIKE**  
**Milena Harito**